

Doracak për trajnerë

M6-A1 - Hyrja dhe pyetjet mbi të priturat

Synimet

- Pjesëmarrësit kanë një vështrim mbi temat
- Pjesëmarrësit janë të njoftuar për organizimin e seminarit
- Pjesëmarrësit vërejnë rëndësinë e temave për ta, karrierën e tyre profesionale dhe mirëqenien personale
- Pjesëmarrësit kanë shprehur atë se çfarë presin ata personalisht nga ky aktivitet.

Qëllimet

- Pjesëmarrësit e ndjejnë veten në vendin dhe aktivitetin e duhur dhe dëshirojnë të bashkëpunojnë
- Pyetjet e pritura i mundësojnë instruktorit të punoj i orientuar kah pjesëmarrësit

Rrjedha

Koha	Tema	Përmbajtja	Metoda	Ilustrimet
0900	Përshëndetja , Prezentimi	Përshëndetja, Prezentimi i Instruktorit	Ligjërimit	Folie # 1
0905	Synimet	Synimet <ul style="list-style-type: none"> ● Pjesëmarrësit kanë një vështrim mbi temat ● Pjesëmarrësit janë të njoftuar për organizimin e seminarit ● Pjesëmarrësit vërejnë rëndësinë e temave për vete, karrierën e tyre profesionale dhe mirëqenien personale ● Pjesëmarrësit kanë shprehur atë se çfarë presin ata personalisht nga ky aktivitet. 	Ligjërimit, Diskutim	Folie # 2
0910	Metodat	Metodat <ol style="list-style-type: none"> 1.Ligjërimit 2.Punë individuale 3.Punë në grupe 	Ligjërimit, Diskutimi	Folie # 3
0915	Vështrimi mbi kapitujt	Kapitujt <ol style="list-style-type: none"> 1. Hyrje dhe pyetje mbi të priturat 2. Çfarë e bënë shkollën,shkollë të mirë 3. Faza 1 - Përcaktimi i fushëveprimit 4. Faza 2 - Përcaktimi i vlerës së duhur 5. Faza 3 - Përcaktimi i metodës vlerësuese 6. Faza 4 - Zbatimi i matjeve 7. Detyra praktike 8. Përfundimi Ndërkohë 9. Thellimi 10. Testi 	Ligjërimit, Diskutimi	Folie # 4 Folie # 5

M6-A1 - Hyrja dhe pyetjet mbi të priturat

0920	Organizimi	Detajet organizative (të konstatohen në seminar) ● Koha ● Ushqimi ● Shfrytëzimi i materialit mësimor ● Rregullat e punës ● etj.	Ligjërime	Flip
0925	Pyetje mbi të priturat	Pyetjet mbi të priturat	Kartat me pyetje	Tabela, Kartat, Lapsat
1000	Pauzë			
1015	Vazhdimi me M6A2			

M6-A2 - Çfarë e bënë një shkollë, shkollë të mirë

Synimet

- Pjesëmarrësit e kanë kuptuar atë modelin -Elementët hyrës - Proceset - Arritjet (Input-proces-outcome)
- Pjesëmarrësit e kanë një ide mbi faktorët, që ta bëjnë shkollën më të suksesshme
- Pjesëmarrësit mund ti dallojnë faktorët në mësim dhe faktorët jashtë mësim

Qëllimi

- Ky model është bazë themelore për të gjitha mendimet e mëtutjeshme të këtij moduli, shih për këtë, edhe është një kusht paraprak për ta kuptuar.
- Ky model përshtatet si instrument për vëzhgimin e shkollës suaj.
- Faktorët e suksesit janë pasqyrë për vetëveprim në shkollë.

Rrjedha

Koha	Tema	Përmbajtja	Metoda	Ilustrimet
1015		Synimi, Qëllimi	Ligjerimi	Folia # 1 Folia # 2
1020	Modeli - Elementët hyrës - Proceset - Arritjet	Gjatë vlerësimit të një shkolle– kur flitet në përgjithësi - bëhet fjalë rreth pyetjeve, se sa me suksesë arrihen synimet e parapara në planet mësimore, dhe është me rëndësi se sa tregohen nxënësit të suksesshëm në mësimet e ardhshme dhe më vonë në veprimtarinë profesionale dhe/ose në jetë. Për këtë do të përdoret Modeli -Elementët hyrës – Proceset – Arritjet e që paraqet logjikën e procesit të prodhimit në shkollë.	Ligjerimi, Diskutimi	Folia # 3
1040	Çfarë e bënë shkollën një shkollë të mirë	Aktivizimi i pjesëmarrësve përmes pyetjeve: Çfarë e bënë shkollën tuaj të suksesshme? Pasi të mblidhen pyetjet dhe të shënohen në Flip ose tabelë, përpunoni pjesën tjetër	Pyetje- Përgjigje	Pin, Flip
1100	Çfarë e bënë shkollën një shkollë të mirë - Faktorët jashtë mësim		Ligjërime Diskutim Studim vetanak	Teksti „Njohuritë për cilësinë e shkollës“ Folie # 4 Folie # 5 Folie # 6

M6-A2 - Çfarë e bënë një shkollë, shkollë të mirë

	Çfarë e bënë shkollën një shkollë të mirë - Faktorët në mësim	Kjo pikë vetëm të përmendet, jo të diskutohet. Arsyetimi: në Kosovë përpiqen që ti përmirësojnë njohuritë pedagogjike të mësimitdhënësve, me një mori programesh.		Teksti „Njohuritë e zgjedhura empirike tek cilësia e shkollës“, Kapitulli 4
1200	Pauza e drekes			
1300	Vazhdimi			
1330	Vazhdimi me M6A3		Ligjërime, Diskutim	Folia # 3

M6-A3 - Faza 1 - Përcaktimi i fushëveprimit shkollor

Synimi

Pjesëmarrësit mund të ndajnë shkollën në fushëveprime shkollore dhe të përshkruajnë ndikimet e ndërsjella mes tyre.

Qëllimi

Përzgjedhja e një fushëveprimi shkollor në analizë mënjanon mbingarkesën përmes detyrave të shumta.

Rrjedha

Koha	Tema	Përmbajtja	Metoda	Ilustrimet
1330	Synimi, Qëllimi	Synimi, Qëllimi	Ligjërimit	Folie # 1 Folie # 2
1335	Përcaktimi i fushave vepruese në shkollë	<p>Bazuar në modelin " Hyrjet- Procesi-Arritjet" mund ta paraqesim shkollën si më poshtë :</p> <p>Shiko të dhënat në Excel.</p> <p>Pjesëmarrësit ndahen në dy grupe dhe secilit grup i jepet nga një komplet me kartela.</p> <p>Detyra</p> <p>1.-rë: Plotësoni pasqyren e shkollës tuaj me fusha të mëtutjeshme veprimi, duke i shkruar në kartela.</p> <p>2.-të: vendosni kartelat në një renditje, e cila përshkruan shkollën tuaj. Paraqitni ndërlidhjen e fushave të veçanta vepruese me anë të shigjetave.</p> <p>Ju, poashtu, mund të mos vendosni ndonjë prej kartave ose</p> <p>Ju mund të shkruani karta të reja dhe ti bashkangjitni.</p> <p>Në forum duhet tani të diskutohen lidhjet e fushëveprimeve shkollore.</p>	<p>Punë në grupe</p> <p>Përgjegjet e pyetjeve</p>	<p>Të dhënat në Excel-M6A3</p> <p>Vizatimi i fushëveprimeve të shkollës;</p> <p>Flip me vizatimin „ Hyrjet-Procesi-Arritjet "</p> <p>Kartat me nocionet nga vizatimi</p>
	Zgjedhja e një fushëveprimi	<p>Detyra:</p> <p>Pasi që pjesëmarrësit kanë krijuar vizatimin e shkollës dhe kan kuptuar lidhshmërit në shkollë, tani duhet të gjejnë fushëveprimet shkollore, ku kanë nevojë për përmirësime.</p> <ol style="list-style-type: none"> Vlerësoni kriteret e vendosura në tabelë Përpiloni një radhitje të prioriteteve për të gjitha temat duke i vlerësuar me "0" ose „-“, 	Punë në grupe	Teksti „M6A3 Përcaktimi i fushëveprimit"
1500	Vazhdimi me M6A4			

M6-A4 - Faza 2 - Përcaktimi i vlerës së duhur

Synimi

Pjesëmarrësit mund të përcaktojnë për një fushë vepruese cilësinë e duhur

Qëllimi

Cilësia e duhur është Synimi, i cili duhet të arrihet. Të gjitha aktivitetet, posaçërisht projektet që duhet formuluar në planin zhvillimor shkollor synojnë në arritjen e cilësisë së duhur.

Rrjedha

Koha	Tema	Përmbajtja	Metoda	Ilustrimet
1500	Synimi, Qëllimi	Synimi, Qëllimi	Ligjërimit	Folie # 1 Folie # 2
1505	Përcaktimi i vlerës së duhur	<p>Vërejtje e përgjithshme: Në fushëveprimet shkollore rrallëherë mund të bëhet saktësisht përcaktimi i një vlere të duhur siç bëhet p.sh. në një ndërmarrje prodhuese.</p> <p>Shembull: tek atmosfera shkollore ose vlerësimi i prindërve mbi shkollën nuk mund të përshkruhet saktësisht vlere e duhur, kështu që duhet pranuar "pasaktësinë" e vlerës së duhur.</p> <p>Detyra: Përcaktoni vlerat e duhura për fushat që keni zgjedhur Për këtë shfrytëzoni si shembull tekstin M6A4 Përcaktimi i vlerës së duhur.</p>	<p>Ligjërimit</p> <p>Punë në grupe</p> <p>Diskutimi në Forum</p>	Folie # 3 Teksti M6A4 Përcaktimi i vlerës së duhur
1700	Fundi i ditës së parë			
	Vazhdimi me M6A5			

M6-A5 - Faza 3 - Përcaktimi i metodës vlerësuese

Synimi

Pjesëmarrësit njihen me shumë metoda vlerësuese dhe mundën në rast nevojë të zhvillojnë metoda të thjeshta vlerësuese vetanake.

Qëllimi

Metodat vlerësuese janë të rëndësishme për përcaktimin e gjendjes - ËSHTË. Krahasimi me -DUHET (qëllimi) mundëson zhvillimin e masave dhe (më vonë) përcaktimin se a është arritur qëllimi apo jo.

Rrjedha

Koha	Tema	Përmbajtja	Metoda	ilustrimet
0900	Synimi, Qëllimi	Synimi, Qëllimi	Ligjërimit	Folie # 1 Folie # 2
0905	Pranimi i gjendjes ËSHTË - Përcaktimi i metodës matëse	<p>Pas përcaktimit të vlerave të duhura duhet të përcaktohen metodat matëse, që të jetë i mundur pranimi i gjendjes- ËSHTË.</p> <p>Lidhur me këtë duhet vendosur për përdorimin e</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Metodave vlerësuese dhe ● Grupeve të personave që duhet të përfshihen në vlerësim. <p>Ky vendim varet nga faktorët vijues:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Koha, për zhvillimin e instrumenteve përcaktues dhe pranimi të gjendjes-ËSHTË dhe ● Saktësia e deklaratave dhe të dhënave që duhet të përpilohen. <p>Instrumentet e zhvilluar vetë janë më efektive se ata të pranuar të gatshëm, për shkak se vetëpërpunimi i këtyre instrumenteve paraqet një kontribut më të madh në zhvillimin e shkollës.</p> <p>Shembuj:</p> <p>Nga ky tekst duhet të nxjerren pyetësorë, dhe të përpunohen nga të gjithë pjesëmarrësit. Udhëzimet e shënuara në tekst për përpilim duhet të diskutohen vetëm në mënyrë formale, nëse paraqitet nevoja.</p>	Ligjërimit	<p>Teksti M6A5 Përcaktimi i metodës matëse</p> <p>Folia # 3</p>
	Shembuj për metodat matëse		Përpunimi i pyetësorëve dhe diskutim	

1130	Ushtrime praktik	<p>Detyra e 1.-rë: Përpunoni një “ shembull të një udhëzuesi për një bisedë të strukturuar” për shkollën tuaj, kështu që kjo ti përfshijë të gjitha proceset administrative.</p> <p>Detyra e 2.-të: Loja me role- biseda e strukturuar – „ Shembulli një doracak për një bisedë të strukturuar“.</p> <p>Udhëheqni dy intervista;</p> <p>Një pjesëmarrës është një mësues dhe është ai që i shtron pyetjet. Ai mban doracakun në dorë;</p> <p>Një pjesëmarrës luan rolin e sekretarit të shkollës.</p> <p>Bisedoni për njohuritë e fituara në plenum.</p> <p>Detyra e 3.-të: Të gjithë pjesëmarrësit e përpunojnë një „ Pyetësor rreth përshtypjes së prindërve për shkollën“;</p> <p>Bisedoni me pjesëmarrësin lidhur me pyetësin:</p> <p>Se a do ta kishit aplikuar këtë pyetësor në shkollën tuaj? Nëse jo, atëherë pse?</p>	Metoda matëse	
1200	Pauza e drekës			
1300	Vazhdimi me M6A6			

M6-A6 - Faza 4 - Zbatimi i vlerësimeve

Synimi

Pjesëmarrësit njihen me këshilla për krijimin praktik të vlerësimeve

Qëllimi

Pjesëmarrësit mënjanojnë gabimet gjatë zbatimit të vlerësimeve dhe rrisin mundësinë e suksesit

Rrjedha

Koha	Tema	Përmbajtja	Metoda	Mediat
1300	Synimi, Qëllimi	Synimi, Qëllimi	Ligjërime	Folie # 1 Folie # 2
1305	Këshilla praktike për zbatim		Ligjërime	Folie # 3 Folie # 4 Teksti M6A6 Këshilla praktike
1320	Ushtrim	<p>Detyra:</p> <p>Zhvilloni një plan veprimi në një kalendar fiktiv (të paramenduar) për një anketim të nxënësve dhe mësuesve mbi klimën në shkollë: Merrni parasysh këshillat praktike nga teksti.</p>	<p>Punë në grupë</p> <p>Diskutim në grupin e madhë</p>	Teksti M6A6 Këshilla praktike
1430	Lidhshmëri në hapat e mëtutjeshëm të punës Hulumtimi i shkakut dhe zhvillimit të masave ndërmarrëse	<p>Pas zbatimit të anketimit, intervistes ose të matjeve dhe pas indentifikimit të fushave shkollore që janë të zhvilluara dobët (përmes krahasimit të gjendjes Është me Duhet), duhet të hulumtohet shkak.</p> <p>Pasi që janë indentifikuar shkaqet, mund të mirren masa praktike të cilat synojnë menjanimin e mungesës.</p> <p>Kjo nuk trajtohet këtu, për shkak se kjo temë trajtohet në Modulin "Plani zhvillimor shkollor".</p>		
1440	Pauzë			
1500	Vazhdimi me M6A7			

M6-A7 - Detyra praktike

Rrjedha

1500	Detyra praktike	Zhvilloni për shkollën tuaj një instrument për përcaktimin e klimës shkollore. Përpiloni një plan, se si mund të praktikohet përcaktimi i atmosferës shkollore në shkollën tuaj. Ti përpunoni të gjitha pikat që janë të cekura tek udhëzimet praktike.	Ligjërime	Folie # 2
1515	Vazhdimi me M6A8			

M6-A8 - Përfundimi

Rrjedha

1515	Përfundimi	<ul style="list-style-type: none"> •Përmbledhja •Barazimi i pritjeve me rrjedhën •Vlerësimi i përmbajtjeve dhe metodave me pjesëmarrësit me qëllim të përmirësimit të konceptit të modulit •Vështrim në ditën e tretë •Përshëndetje 		Folie # 2
1600	Fundi			

Fillimi i fazës së gjendjes së përkohëshme

Dita e tretë më: ...

M6-A9 - Thellimi

Qëllimi

Pjesëmarrësit kanë rastin, që materialin e Modullit të shtjelluar në dy ditët e para të punës, dhe në autodidakte si dhe gjatë detyrës praktike të thellojnë edhe më tutje me ligjeruesit dhe kolegët.

Rrjedha

Koha	Tema	Përmbajtja	Metoda	Mediat
0900	Hyrje	Qëllimi	Ligjërime	Folie # 1 Folie # 2
0905		<ul style="list-style-type: none"> Ligjërime dhe diskutim i moderuar për rastet praktike, shkëmbim i përvojës në mes kolegëve - diskutimi I thelluar për materialin mësimor 		
1600	Vazhdimi me M6A10			
1700	Fund			

M6-A10 - Testi

Rrjedha

Koha	Tema	Përmbajtja	Metoda	Mediat
1600	Testi	Formulari, përgjigje të shumfishta		
1700	Fund			

Testi i modulit të 6. - Delegimi

Mbiemri:

Emri:

Data:

Udhëzim për zhvillimin e testit:

Pikat kanë së paku dy mundësi të zgjidhjes.

Prej tyre së paku njëra është e saktë.

Vini një kryq në mundësitë e sakta të zgjidhjes.

Në rast se keni vënë kryqin në një mundësi të gabuar, atëherë hiqni një vijë nëpër kuti:

Teksti i përgjigjes...

Testin e kaloni nëse i përgjigjeni saktësisht shtatë pikave prej gjithësej dhjetë.

1: Drejtori mund të vështron shkollën e tij me anë të modelit Elementët hyrës- Procesi-Rezultati. Me këtë rast prezentohen edhe marrëdhëniet me botën jashtë shkollës. Ky model veç tjerash krijon varësi në mes të

- suksesit të absolventëve të shkollës në jetën e të rriturve dhe kualitetit të shkollës.
- kualitetit të mësimit dhe të asaj, se çka sjellin me vete nxënësit nga shtëpia prindërore.
- kualitetit të tregut të punës dhe kualitetit të shtëpisë prindërore të nxënësve.
- kualitetit të mësimit dhe kualitetit të arsimimit të mësimitdhënësve në universitet.

2: Drejtori mund të vështron shkollën e tij me anë të modelit Elementët hyrës- Procesi-Rezultati. Me këtë rast shkolla prezentohet në mënyrë interne e ndarë në „fushëveprimet shkollore“. Ky model veç tjerash krijon varësi në mes të

- kualitetit të udhëheqjes dhe kualitetit të mësimit.
- resurseve (p.sh. materialet mësimore, të hollat, mësonjëtoret) dhe kualitetit të mësimit.
- kualitetit të organizimit të shkollës dhe kualitetit të mësimit.

3: Mbi tiparet e një shkolle të mirë në mbarë botën ekzistojnë hulumtime të shumta shkencore. Cilat njohuri janë të sakta?

- Disiplina dhe rregullat janë të parëndësishme.
- Është me rëndësi angazhimi pedagogjik dhe një udhëheqje këmbëngulëse e mësimit.
- Janë me rëndësi pritjet e larta mësimore nga nxënësit.

4: Për të konstatuar, se në çfarë gjendje është shkolla, duhet të përshkruhet realiteti. Për këtë shfrytëzohen instrumentet. Këto janë veç tjerash

- raporti, p.sh. i përpiluar nga një mësues.
- doracak për realizimin e një bisede të strukturuar.
- një pyetësor për realizimin e një intervistimi, p.sh. të prindërve.
- analiza e përparësive dhe dobësive.

5: Përcaktimi i vlerës së duhur varet nga formulimi matës i saj. E saktë është p.sh. tek vlerësimi i prindërve mbi shkollën

- „Prindërit japin një vlerësim të mirë mbi shkollën“.
- „60% i prindërve japin një vlerësim të mirë mbi shkollën“.

6: Vëzhgimet bëhen nga ana e drejtorit p.sh. për vlerësimin e mësuesve. Çka është më mirë?

- Drejtori vëzhgon një mësues dhe „ndien“, nëse mësimi zhvillohet mirë apo keq. Përveq kësaj ai krahason, se si ai kishte për të zhvilluar mësimin.
- Drejtori shfrytëzon një listë të kriterve të vlerësimit për vëzhgimin e mësimit. Në këtë mënyrë vlerësimet e tij mbi të gjithë mësuesit bëhen në mënyrë shumë të drejtë, sepse gjithëmonë janë përdorur kriteret e njëjta.

7: Drejtori është përgjegjës për kualitetin e shkollës në përgjithësi. Për të mundësuar përmirësimet, më e dobishmja është mënyra vijuese e veprimit:

- 1. Përcaktimi i fushëveprimit të shkollës (Kulturë, synimet e shkollës - mësimi - udhëheqja e shkollës - jeta shkollore - organizimi i shkollës - resurset etj...), në të cilën **supozohen** dobësitë.
 - 2. Përcaktimi i vlerës së duhur (si duhet të duket fushëveprimi shkollor ?)
 - 3. Përcaktimi i metodave të matjes (si duhet të matet?)
 - 4. Realizimi i matjes.
-
- 1. Përcaktimi i vlerës së duhur (si duhet të duket fushëveprimi shkollor ?)
 - 2. Përcaktimi i fushëveprimit të shkollës (Kulturë, synimet e shkollës - mësimi - udhëheqja e shkollës - jeta shkollore - organizimi i shkollës - resurset etj...), në të cilën **supozohen** dobësitë.
 - 3. Përcaktimi i metodave të matjes (si duhet të matet?)
 - 4. Realizimi i matjes.
-
- 1. Përcaktimi i metodave të matjes (si duhet të matet?)
 - 2. Përcaktimi i vlerës së duhur (si duhet të duket fushëveprimi shkollor ?)
 - 3. Përcaktimi i fushëveprimit të shkollës (Kulturë, synimet e shkollës - mësimi - udhëheqja e shkollës - jeta shkollore - organizimi i shkollës - resurset etj...), në të cilën **supozohen** dobësitë.
 - 4. Realizimi i matjes.
-
- 1. Përcaktimi i metodave të matjes (si duhet të matet?)
 - 2. Realizimi i matjes.
 - 3. Përcaktimi i vlerës së duhur (si duhet të duket fushëveprimi shkollor?)
 - 4. Përcaktimi i fushëveprimit të shkollës (Kulturë, synimet e shkollës - mësimi - udhëheqja e shkollës - jeta shkollore - organizimi i shkollës - resurset etj...), në të cilën **supozohen** dobësitë.

8: Bisedimet e strukturuar janë një prej metodave të mundshme për matjen e gjendjes ËSHTË. Personi i i ngarkuar me realizimin e tyre udhëheq bisedën e strukturuar me më shumë persona, të cilët duhet të intervistohen. Cili përshkrim është i saktë?

- Bisedat e strukturuar nuk rrjedhin rastësisht, por me ndihmën e një doracaku ose me ndihmën e një liste kontrolluese.
- Bisedat e strukturuar rrjedhin me ndihmën e pyetjeve, të cilat i zbulon udhëheqësi gjatë rrjedhës së bisedës.

9: Pyetëtori është

- një instrument për intervistime.
- një instrument i bisedës së strukturuar.
- Një instrument për zgjedhjen e këshillit të shkollës.

10: Një metodë shumë efektive e matjes është analiza e përparësive - dobësive.

- Analiza e përparësive - dobësive përbëhet prej një liste të kriterëve, të cilat të gjitha së bashku bëjnë përshkrimin e shkollës.
- Analiza e përparësive - dobësive bëhet më së miri nga ana e të gjithë mësimitdhënësve dhe nga personeli jomësimitdhënës.
- Analiza e përparësive - dobësive bëhet më së miri nga vet drejtori. Me anë të kësaj pengohet dyshimi për autoritetin e tij.

Zgjedhjet

1	
	X
	X
	X

2	
	X
	X
	X

3	
	X
	X

4	
	X
	X
	X
	X

5	
	X

6	
	X

7	
	X

8	
	X

9	
	X

10	
	X
	X